

VENDIM
Nr. 190, datë 26.3.2026

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI
NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË AFËRSI TË FSHATIT VËRNIK, NJËSIA
ADMINISTRATIVE QENDËR BILISHT, BASHKIA DEVOLL, QARKU KORÇË,
NGA SHOQËRIA “KRONOS KONSTRUKSION” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në afërsi të fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, qarku Korçë, nga shoqëria “Kronos Konstruksion” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: shoqëria “Kronos Konstruksion” sh.p.k.;
- b) NIPT/NUIS: K41416033P;
- c) Tipi i centralit: fotovoltaike;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 50 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaike do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në afërsi të fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, qarku Korçë;
- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës dhe plan-vendosja sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;
- g) Shoqëria “Kronos Konstruksion” sh.p.k., ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj), pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaike;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprahe mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “Kronos Konstruksion” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penaltetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;
 - iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “Kronos Konstruktion” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

ANEKSI 1

Koordinatat në KRRGJSH për “Kronos Konstruktion” sh.p.k. Pasuria nr. 1728, ngastra nr. 7					
Nr.	E	N	Nr.	E	N
P1	585862.664	4499283.357	P6	586138.331	4500346.116
P2	586289.4974	4499391.368	P7	586168.799	4500270.63
P3	586527.2396	4499660.125	P8	586137.821	4500150.433
P4	586240.4514	4500001.657	P9	586025.56	4499523.987
P5	586188.735	4500361.37			

Koordinatat në KRRGJSH për “Kronos Konstruktion” sh.p.k. Pasuria nr. 1443, ngastra nr. 17 dhe pasuria nr. 1445, ngastra nr. 18					
Nr.	E	N	Nr.	E	N
P1	587004.261	4501292.213	P10	586942.360	4501801.511
P2	587242.966	4501254.613	P11	586977.962	4501731.831
P3	587620.089	4501352.237	P12	587154.892	4501724.998
P4	588029.497	4501477.151	P13	587257.095	4501772.315
P5	587881.121	4502020.695	P14	587499.826	4501949.819
P6	587626.706	4502309.42	P15	587762.366	4501823.142
P7	587451.518	4502219.632	P16	587374.982	4501508.158
P8	587144.083	4502021.085	P17	587062.508	4501495.691
P9	586963.399	4501878.216			

